

Pjesë nga libri

## ***Unspeakable Truths***

Autorja Pricilla B. Hayner

Samizdat B92, Beograd, 2003.

Përkthim i tekstit Why truth commission?

## **Pse komisioni për të vërtetën**

Përveq vërtetimit dhe komunikimit të së vërtetës, zyrtarëve për të vërtetën shpesh iu është besuar detyra me një shtrirje të gjerë. Në disa raste ato janë bërë iniciativa më të theksuara të qeverisë të cilat merren me krime të së kaluarës dhe pikë kryesore prej të cilës lëvizin masa të tjera në thirrje për përgjegjësi, dëmshpërblim dhe programe të reformave. Arsytet të cilat në shtojcë kanë përmbajtur themelimin i komisionit për të vërtetën ndryshojnë nga vendi në vend. Disa për shembull, e theksojnë pajtimin nacional dhe nevojën që e kaluara të lihet *ad acta*; të dytët e kanë definuar si hap në drejtim të ndjekjes penale e cila do të pasojë ndërsa të tretët hetimin për të kaluarën e konsiderojnë si mënyrë që politika e qeverisë së re të distancohet prej regjimit të mëparshëm dhe të theksojë si epokë e re e respektimit të të drejtave.

Edhe pse paraqitet e theksuar me shkallë të ndryshme, komisioni për të vërtetën mund të ketë ndonjë ose të gjitha pesë qëllimet themelore; të zbulojë, të ndriqojë dhe të pranojë në mënyrë zyrtare shkeljet e të drejtave në të kaluarën; të përgjigjet në kërkësat e posaqme të viktimave; ti kontribuojë drejtësisë dhe përgjegjësisë; që në pikat kryesore të paraqesë përgjegjësinë institucionale dhe rekomandoj reforma; të nxisë pajtime dhe të zvogëlojë debatet ndaj të kaluarës.

### **Ndriçimi dhe pranimi i së vërtetës**

Qëllimi themelor i komisionit për të vërtetën është vërtetimi zyrtar i fakteve: që të paraqesë dokumentacion të saktë për të kaluarën e vendit, të sqarojë ngjarje problematike dhe të ndalojë me heshtjen ndaj periudhës historike të diskutueshme dhe të dhimbshme dhe mohimin e saj. Numri i madh i bisedave me viktimat, që është tipike për këto komisione, mundëson që veqanërisht të përshkruhet dhuna në një periudhë kohore dhe në të gjithë regjionin, me qka në kuptimin e plotë nënvizohen histori të fshehta.

Specifika dhe gjërësia e informatave në raportin e komisionit për të vërtetën zakonisht për nga lloji dhe kualiteti janë shumë më të mirë së çdo përshkrim historik i mëparshëm, sepse vendit i lejnë fakte të shkruara dhe të dokumentuara për ngjarje shpesh të kontestuara. Përveq që i përshkruajnë format gjithëpërfshirëse, disa komisione për të vërtetën kanë shpjeguar shumë raste të rëndësishme, sa që edhe i kanë emëruar shkakëtarët e krimeve më të rënda të pa zgjidhura ose edhe krijuesit (frymëzuesit) intelektual në pozita ta larta. Zyrtarisht dhe publikisht pranimi i shkeljeve të të drejtave në të kaluarën shërben në

mënyrë efikase të ndalohet heshtja mbi temat për të cilat në rast të kundërt kishte mu fol vetëm me gjysëm zëri, mbi të cilën në shtyp rrallëherë kishte për tu raportuar në mënyrë të ndershme, dhe e cila gjithsesi ka qenë jashtë kuadrit të historisë, e ligjësuar zyrtarisht nëpër shkollat. Në të vërtetë raporti i komisionit për të vërtetën, vendit ia kthen historinë e saj dhe e hapë atë për rishikim publik dhe kritik.

Në disa vende aktivistët për të drejtat e njeriut insistojnë që komisioni për të vërtetën të mos gjejë aq shumë të vërtetën e re deri sa të ngritet velloja e mohimit gjërësisht e njohur, por më të vërteta të pathëna. Mohimi energjik mund të jetë i pranishëm në ato vende ku qeveria represive në zbatimin e politikës së tyre dhe ruajtjen e qeverisjes është mvarur prej përkrahjes publike aktive dhe pasive ose të sektorëve të tjerë publik. Aktivistët kundër apartheidit në Afrikën e Jugut me këmbëngulje kanë pohuar se si ka qenë e pamundur që cilido Afrikanojugor nuk e ka ditur që tortura, vrasja dhe taktikat e tiranëve kundër rivalëve kanë qenë qenë gjë e zakonshme në regjimin e apartheidit: që njëri i përveq nëse qëllimisht nuk kanë zgjedhur që ti mbyllin sytë për të mos e parë të vërtetën do të duhëj të dijnë. Disa Afrikanojugorë prandaj konkludojnë që kontributi kryesor i komisionit ishte ai që thjesht e përjashtoi mundësinë për refuzim të mëtejshëm. Edhe pse ithtarët e kaluar të apartheidit në fillim shprehën mosbesim por kur në sipërfaqe filluan të dalin storiet e mizershme të viktimave, në vazhdim të dëgjimit para komisionit, vëqanërisht kur para foltores filluan të dalin keqbërësit të cilët dëri në të vërtetën e fundit filluan ti përshkruanin torturat dhe vrasjet në të cilat ishin të përfshira, për të gjithë u bë e pamundur që të hedhet e vërteta e dëshmisë.

Ashtu siq ka thënë shkrimtari Majki Ignjatijef: "E kaluara është argument dhe funksioni i komisionit për të vërtetën, ashtu siq është funksioni i historianëve që të pastrojnë mosmarrëveshjet, që të shkurtojnë listën e gënjeshtrevë të lëjuara."<sup>1</sup>

Mirëpo, në krahasim me shumë të bardhë, zezakët e afrikës jugore zakonisht faktet për shkelje të të drejtave të cilët i kanë kryer forcat shtetërore nuk i kanë befasuar shumë; ata personalisht kanë qenë viktimat dhe dëshmitarët të shkeljes së drejtave. Dhe për më tepër, në shumë situata të cilat e justifikojnë ekzistencën e komisionit për të vërtetën në post-tranzicion, popullata e torturuar tanimë mund të ketë një shfaqje të mirë për atë së çfarë ka ndodhur dhe kush ka qenë përgjegjës, ndërsa hetimet vërtetojnë vetëm besimet e bollshme për ngjarjet ose veprimet për të cilat bëhet fjalë. Në disa vende egërsitë kanë ndodhur qoftë me njohjen e hapur të përgjegjësve (siq janë rëmbimet politike ose lajmërimet publike për cilat grupe ose persona janë në shënjestër) ashtu si personat me uniformë që i kanë lënë dëshmitarët e akteve të tyre (si në raste të rëmbimeve publike, aktivistëve ose vrasjeve masive të cilat i kanë bërë forcat e armatosura). Kjo ndjenjë e viktimave të cilët veq e dinë të vërtetën, prandaj shumë pak të reja mësojnë nga komisioni, fatkëqësia e fakteve qëndron në një numër të vogël të viktimave të cilët dëshmojnë para komisionit për të vërtetën, në mënyrë që janë të marrin vesh diçka të re për rastet e tyre. Për shkak të numrit të madh të dëshmitarëve të marrura, për kohën dhe mjetet e limituara, komisionet për të vërtetën mund të ndërmarrin hetime serioze vetëm edhe me rast të numrit të vogël të dëshmitarëve. Shumica prej më shumë së njëmijë dëshmitarëve janë të regjistruara saktësisht ashtu siq kanë thënë dëshmitarët si dhe është e përdorur për analizë statistike të trendeve, fatkëqësisht kurrë nuk është hetuar më thëllësisht.

---

<sup>1</sup> Michael Ignatieff, "Articles of Faith", Index on Censorship 25, no. 5 (1996), str. 113.

Për disa viktima dhe të mbijetuarë, komisioni për të vërtetën nuk e komunikoi asnjëherë të vërtetën e re sa e një zyrtarisht të vërtetën të cilën ata kryesisht e dijnë. Në veprimin e mbledhjes së dëshmitarëve dhe publikimit të raportit zyrtar, komisioni ofron vërtetim zyrtar për faktet të cilat kanë qenë të heshtura shumë gjatë. Kryetari mund të shfrytëzojë mundësinë e pranimit të raportit të komisionit për të dhënë deklarata me të cilën kërkon falje në emër të shtetit. Kur për shëmbull kryetari Patricio Aylwin e dorëzoi raportin çilean për të vërtetën, ai përmes televizionit nacional iu kërkoi familjeve të viktimave lutje të prekshme për falje, ku të mbijetuarit e përmendin këtë akt si një çast tronditës pas shumë viteve të shurdhëra ndaj kërkesave të tyre.<sup>2</sup> Ai pastaj ua dërgoi nga një kopje secilës familje që kishin viktima dhe që ishin të shkruar në raport së bashku me një letër në të cilën ishte i shënuar numri ku përmendej rasti i tyre.

Kjo diferencë ndërmjet njohjes dhe pranimit të cilën shpesh e kanë vërejtur vëzhguesit e komisionit për të vërtetën, për herë të parë është thënë qartë në vitin 1988 në një prej konferencave të mëdha për drejtësinë dhe tranzicionin.<sup>3</sup> „Pranimi nënkupton që shteti i ka pranuar veprimet e tij dhe që veprimet të tilla kanë qenë të gabuara“ shkruan Arije Nejer, president i Institutit për shoqëri të hapur si dhe ish drejtor ekzekutiv i organizatës Human Rights Watch.<sup>4</sup> Huan Mendes, avokat i nderuar për të drejtat e njeriut shkruan që „Njohja e cila është e vërtetuar zyrtarisht dhe si e tillë është bërë pjesë publike e skenës kognitive'...arrin një mister në vehte e cila në të nuk është kur është vetëm e vërteta'. Pranimi zyrtar bile fillon atëherë të shërojë plagët<sup>5</sup>.

Pranimi zyrtar mund të jëtë i fuqishëm vetëm sepse mohimi zyrtar është asnjëherë i shumë pranishëm. Disa e masin nevojën me të drejtën zyrtare, dhe prej aty daton përshtatshmëria e komisionit për të drejta, në shkallë në të cilën qeveria është munduar që të mshefë natyrën e vërtetë të regjimit të saj. Arije Nejer thekson që nevojën për të hulumtuar të vërtetën e përcakton se sa barbarizma kanë qenë të fshehura. Disa qeveri janë munduar që të ruajnë legjitimitetin ndërkombëtar por në të njëjtën kohë kanë bërë shkelje të të drejtave – sikur disa qeveri latinoamerikanë në marrëdhënjet e tyre me Shtetet e Bashkuara“ në disa vënde krimet janë bërë më qëllim që të mund të fshihen lehtë: ushtarët kanë veshje civile dhe vozisin automjete pa targa, njëzëit humbin pa lënë gjurmë. „Në këto krime gjithçka është bërë me qëllim që të mund të mohohet. Kur në shkelje të të drejtave

---

2 "Discurso de S.E. el Presidente de la Republica, Don Patricio Aylwin Azocar, al dar a Conocer a la Ciudadania el Informe de la Comision de Verdad y Reconcitacion", 4. mars 1991; I botuar ne gjuhen angleze si "Statement by President Aylwin on the Report of the National Commission on Truth and Reconciliation" u Kritz, Transitional Justice, 3. libri, fq. 169-173.

3 Rezultat I kesaj conference eshte libri *State Crimes: Punishment or Pardon*, Aspen Institute, New York, 1989. Profesor Thomasu Nagelit nga universiteti I Njujorkut shkruhet qe I pari e ka artikulluar kete difference ndermjet Njohjes dhe Pranimit.

4 Aryeh Neier, *What Should Be Donë about the Guilty?*, New York Review of Books, 1. shkurt 1990, fq. 34.

5 Juan Mendez, përshkrim me titull *A Miracle, A Universe te cilin e ka shkruar* Lavwrence Weschler za New York Law School Journal of Human Rights 8 (1991), str. 8.

6 Aryeh Neier në bisedë telefonike me autoren 31. korrik 1996.

mashtrimi luan rol kryesor , e vërteta merr rëndësi edhe më të madhe. Zbulimi i së vërtetës në këso rrethana jep një shkallë të caktuar të fuqisë“ shpjegon Njëjër.<sup>6</sup>

Zhdukja e ndonjë personi është forma më e pa vlerë e barbarizmit me mashtrim, me qëllim të dukshëm që të gënjëhet, të mbulohet dhe të mos flitet. Por, nuk janë zhdukjet të vetmet të cilat mund të mbesin të fshehura; edhe masakrat e mëdha kanë mbetur të pa shpjeguar në disa vende, ndërsa zyrtarisht dhe me plot energji nuk janë pranuar edhe atëherë kur kanë ekzistuar fakte të rëndësishme për të kundërtën. Me qindra masakra kanë ndodhur në malet e guatemales në fillim të viteve të tetëdhjeta në kohën e kampanjës së ushtrisë për ti shkatërruar guerilët e armatosur dhe përkrahësit e tyre. Mirëpo njëherë e tjetër e kanë pasë të ndaluar të hyjnë në ato teritore, gjë që e ka bërë të pamundshëm që lajmi për masakrën të dalë jashtë saj. As shumica prej atyre që e kanë mbijetuar masakrën nuk e kanë ditur që masakra të ngjashme ndodhnin edhe në vende tjera. Pasi që ushtria i ka ndaluar ata që të shkojnë në fshatrat fqinje, zakonisht në largësi prej disa orësh në këmbë, shumica kanë menduar që në shënjestër ka qenë vetëm fshati i tyre.

Por, edhe në ato raste kur duket që ngjarjet po shkruhen në kohën kur ndodhin, faktet themelore edhe më vonë mund të jenë tmerësisht të ngadalsuara, ndonjëherë edhe me qëllim gabimisht të paraqitura për t'u shërbyer qëllimeve politike. Pavarësisht nga raportimi i drejtpërdrejt për luftën në bosnje, në Bosnje ekzistojnë tri verzionë në kundërthënje për të vërtetën zyrtare se qfarë në të vërtetë ka ndodhur në atë luftë, secilin verzion e ligjërojnë nëpër shkolla të ndryshme dhe nëpër bashkësi të ndryshme – myslimane, kroate ose serbe – ku përforcohen pyetet themelore konfliktuoze prej të cilës në të ardhmen shumë lehtë mund të shpërthejë dhuna. Boshnjakët në vitin 1998 kanë filluar të mendojnë për komisionin për të vërtetën në mënyrë që të përcaktohet një shpejtim historik i dokumentuar njëzëshëm dhe ligjërish.

### **Tu përgjigjesh nevojave dhe interesave të viktimave**

Ndryshimi themelor ndërmjet gjykimit dhe komisionit për të vërtetën është në natyrën dhe shkallën e përkujdesjes ndaj viktimave. Funksioni i parë dhe kryesor i sistemit të gjyqësisë është që të hetohen aktet e përcaktuara të kryesve të akuzuar. Gjatë kohës së gjykimit viktimat ftohen që të dëshmojnë vetëm nëse është e nevojshme për tu vërtetuar deklarimi për rastin, gjë që zakonisht përfshihen një sërë rastesh të cilët e përbëjnë krimin i cili ndiqet. Zakonisht një numër mjaft i vogël i viktimave ftohet për të dëshmuar, ndërsa dëshmia e tyre me siguri menjëherë apo ndoshta edhe me agresivitet do të hidhet poshtë nga avokatët mbrojtës. (në disa raste viktimat mund të luajnë rol kritik pasi që aktivisht mund të kontribuojnë që procesi të zhvillohet në favor të padisë).

Në dallim prej saj, shumica e komisioneve për të vërtetën është e planifikuar në atë mënyrë që në qendër të vëmendjes të jenë viktimat. Edhe pse komisionet mund të hetojnë përzjerjen e disa kryesve që kanë shkëlur ligjin dhe mund të pranojnë informata kritike pasi që iu referohen kryesve të gabuar dhe personave të tjerë të sistemit represiv, ata shumë kohë dhe kujdes iu kushtojnë viktimave. Zakonisht i marrin deklaratat prej shumë dëshmitarëve dhe të mbijetuarve dhe të gjitha këto storie i shqyrtojnë kur e analizojnë dhe përshkruajnë ngjarjen në tërësi. Së pari e dëgjojnë tregimin e viktimave, ndoshta

edhe bëjnë kërkime publike dhe publikojnë raporte në të cilat përshkruhet repertoari i gjerë i vuajtjeve, komisioni viktimave me sukses mundeson që të degjohen në publik dhe që vuajtja e tyre të arrijë deri në vetëdijen e publikut. Si janë realizuar kërkimet para komisionit afrikanojugor ashtu janë përshembull terapatutët të cilët kanë punuar me persona të cilët i kanë mbijetuar torturës kanë bërë të mundshëm që në masë dukshëm të rritet mirëkuptimi për viktimë dhe njohja e nevojave të tyre. Në disa viktimë dhe të mbijetuar ky proces mund të ndikojë si katarza apo shërim.

Komisionet mund të shërbejnë nevojave të viktimave në mënyra të tjera: disa ndihmojnë në konceptimin e programit, dëshmipërblim viktimave ose familjeve të të vrarëve në dhunën politike, e në disa raste lista e viktimave të cilën e ka përpiluar komisioni për të vërtetën shërbejnë si listë e përfituësve kur fillon programi i dëshmipërblimeve.

Dhe në fund, në nivelin praktik, shumë anëtarë të famileve të zhdukura me padurim dëshirojnë që zyrtarisht të formohet statusi ligjor i më të afërmeve të tyre. Shumë pyetje të qytetarëve nuk mund të zgjidhen pa dëshmi të vdekjes – siq janë plotësimi i testamentit ose qasje në mjete të të zhdukurit i cili është në llogari të bankës. Në Shri Lanka, Argjentinë dhe gjetiu këto arsye shumë praktike dukshëm kanë rritur vuajtjet e të mbijetuarve. Në Argjentinë, shteti ka shpikur status të ri ligjor i *zhdukur i detyruar* i cili është i njëjtë me dëshminë e vdekjes, dhe ka bërë të mundshëm që pyetjet e qytetarëve të zgjidhen që personi të mos deklarohet për dëshmi të vdekjes. Ky status ka qenë i dedikuar për të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në dokumentacionet e komisionit për të vërtetëta.

### **Ti kontribuohet drejtësisë dhe përgjegjësisë**

Në vend që të shtyjë ose ta ndërrojë drejtësinë nëpër gjykata, komisioni ndonjëherë mund të kontribuojë që keqbërësit të thirren në përgjegjësi. Shumë komisione ia dorëzojnë dosietë e tyre organeve të gjykatës, ndërsa atjë ku funksionon sistemi gjyqësor, shumë fakte dhe dëshira politike mund të rezultojnë me gjykime. Disa komisione i kanë bërë publike emrat e kriminelëve kështu që së paku moralisht janë dënuar. Disa kanë rekomanduar sanksionë të tjera të cilat do të mund të zbatoheshin pa gjykim, siq janë largimi i shkelësit të ligjit nga vendi i shërbimit të sigurisë ku mund të vazhdonin të bënin këq.

### **Përgjegjësia insitucionale rekomandimi i reformave të shfaqet në vija primare**

Përveq që mirren me rolin përkatës të keqbërësve, komisionet për të vërtetën janë në pozitë të mirë që të vlerësojnë përgjegjësinë e institucionëve për shkelje të mëdha të të drejtave dhe në vija primare shfaqin dobësi në struktura insitucionale ose të zakoneve ekzistuese të cilat do të duhej ti ndërrojnë për ti ndaluar përsëritjet e keqpërdorimeve në të ardhmen. Ka mundësi që komisioni të mund të ndihmonte që të ndalohën shkeljet e të drejtave në të ardhmen, thjesht dukë publikuar dokumentacionin e saktë të shkeljeve të tyre në të kaluarën, me shpresë që qytetarët e informuar të njohin mirë secilën shenjë të kthimit në qeverinë represive dhe që do të shfaqnin rezistencë. Mirëpo paqja e së ardhmes dhe sjellja njerëzore, në raste të tilla më shumë do të mvaren nga ndryshimet insitucionale në të cilat kanë ndodhur këto shkelje, policia, ushtria si dhë insitucionet përgjegjëse për parandalimin e shkeljes të të drejtave dhe të ndëshkohet shkelësi pra gjykatat. Komisionet për të vërtetën janë në pozita unike që të mund ta marrin këtë

detyrë, ta vlerësojnë dhe të bëjnë përgatitjet e duhura përr përshkrim, prandaj përfundimet dhe rekomandimet e tyre mund ti themelojë në studimin e kujdesshëm të dokumentacionit, dhe në të njëjtën kohë të ekzistojnë si institucione të pavarura të ndara nga sistemi i cili është lëndë e hetimit. Zakonisht nuk ekziston asnjë trup tjetër i shtetit e cila është në gjendje që përshembull në mënyrë kritike të shqyrtojë punën e atëhershme dhe mungesat e sistemit gjyqësor. Në fund, aplikimi i reformave të cilën e rekomandon komisioni për të vërteta mvaret prej interesit dhe dëshirës politike të atyre që janë në qeveri. Rekomandimet e shumicës së komisioneve nuk ishin të obligueshme edhe pse janë të shfrytëzueshme sepse japin një udhërrëfim për ndryshime dhe krijimin e punkteve përmes të cilëve shoqëria civile ose bashkësia ndërkombëtare të bëjë prësion duke kërkuar reforma.

### **Nxitja e pajtimit dhe zvogëlimi i grindjeve të cilat janë rrjedhë e dhunës nga e kaluara**

E vërteta banale është që e ardhmja mvaret nga e kaluara: njëri duhet të përballet me trashëgimi të tmershme nga e kaluara ose nuk do të ekzistonte shtylla në të cilën do të ndërtohej shoqëria e re. Fshehi mëkatët e tua, ndërsa ato do të dalin në sipërfaqe më vonë. Lidhe të kaluarën e shëmtuar në ndonjë thes, thesi do te hapet në momentin më të pa përpshatshëm. Mundohu që të heshtësh të kaluarën, ato do të opsionojnë përgjithmonë - me rrezikun që shoqëria të mund të hap cikle të reja të dhunës, mërziisë, dhimbjes dhe hakmarrjes. Nëse vazhdimisht përballemi me konflikte të vjetra, mendohet se pak ka mundësi që ato në të ardhmen të shpërthejnë në forma të dhunës së rëndë ose konflikte politike. Gjithashtu, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe pastrimi i konflikteve latentë mund të ndihmojnë që të ulet tendosja. Megjithatë, në disa rrethana, në mes të tranzicionit të ndijshëm, thënja e së vërtetës mund edhe të rrit grindjet, veqanërisht nëse ato të vërteta i referohen në faj të personave të fuqishëm ose forcave të armatosura të cilat nuk pendohen për krimin e bërë në masa të mëdha. Qeveria mundet, që është e kuptueshme në atë arenë të hyjë më pjekuri të madhë<sup>7</sup>.

Duke menduar në të njëjtën mënyrë, ashtu si është vërjetur më parë, shumë ithtarë të hetimeve për të vërtetën pohojnë që falja dhe pajtimi do të rrjedhin nga zbulimi i së vërtetës së plotë. Si mund të falin viktimat nëse nuk dinë *kend duhet ta falin dhe qka është ajo që duhet të falin?* Qëllimi i pajtimit është i lidhur ngusht më dikë nga komisionet e mëhershme për të vërtetën dhe se shumë vëzhguës sipërfaqësorë besojnë që pajtimi është pjesë përbërëse, ose edhe qëllimi kryesor për të cilën është themeluar komisioni për të vërtetën, por që çdo herë edhe nuk është e saktë.

Dhe në fund, përveq këtyre arsyeve specifike për ndërmarrjen e hetimeve për të vërtetën, disa vëzhguës theksojnë që zbulimet dhe publikimet e të vërtetave për shkeljen e të drejtave në të kaluarën paraqet detyrat e shtetit, e konfirmuar më të drejtë ndërkombëtare, ashtu edhe të gjitha viktimat, të mbijetuarit ose shoqëria si tërësi kanë të drejtë inherente në të vërtetën. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut i detyron shtetet që në të

---

<sup>7</sup> Në të vërtetë deri më sot asnjë komision për të vërtetën nuk ka pasur si rrjedhojë konfliktin e as qe e ka inicuar. Me pyetjen ndermjet hetimit të së vërtetës dhe zgjidhjes së konfliktit, duke e përfshirë mundësinë që komisioni për të vërteta te ndaloje dhunë te tjera, më gjerësisht është marrë: Priscilla B. Haynër, "Past Truths, Prësënt Dangërs: Thë Rolë of Official Truth Sëeking in Conflict Rësolution and Prëvëntion" u Paul C. Stërn i Daniël Oruckman, urëdnici, *Intërnational Conflict Rësolution Aftër thë Cold War*, National Acadëmv Prëss, VVashington, D.C., izlazi 2000.

shumtën e rasteve ti hetojnë dhe ti ndëshkojnë shkelësit e të drejtave të njërit, dhe kjo detyrë sipas deklaramit të avokatëve për të drejtat e njërit, nënkupton të drejtën inherente të qytetarëve që të njihen me rezultatet e atyre hetimeve. Frenk La Ri prej qendrës aksioni për të drejtën e të drejtave njerëzore në Guatemalë dhe Ricard Karver, ish president i organizatës *Artikulli 19* në Londër janë ndër njerëzit e parë të cilët në vitin 1993 në publik e kanë shprehur këtë të drejtë për të vërtetën. Karveri ka shkruajtur: Artikulli 19 thotë që me të vërtetë ekziston e drejta për ta gjetur të vërtetën e cila është e mbajtur në të drejtë që të kërkohet, të mirret dhe të komunikohet informata me anë të artikullit 19 Deklaratës së përgjithshme për të drejtat e njeriut“ ai gjithashtu citon ngjashëm „ E drejta për të marrë informata“nga Karta e Afrikës për të drejtat e njeriut dhe të popujve<sup>8</sup> Luftëtarët për të drejtat e njërit gjithashtu tregojnë në gjykimin e gjykatës Interamerikane për të drejtat e njeriut të realizuar në gjykim të Velaskes Rodrigezit në vitin 1988 ku është konkluduar që shteti e ka për detyrë që të hulumtojë fatin e të zhdukurit dhe ti jap informata familjes<sup>9</sup>.

---

<sup>8</sup> Article 19, "Malawi's Past: The Right to Truth", *Censorship News* 29 (1993), str. 3

<sup>9</sup> Shih, per shembull, Juan Mendez, "Accountability for Past Abuses", *Human Rights Quarterly* 19 (1997), fq. 255-282.